



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr 361 prot.

Tiranë, më 16.06.2023

V E N D I M

Nr.2, datë 31.05.2023

P Ë R

**“MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR DISA ZONA KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, DRIN-BUNË 4, 5 DHE 6 (TERRITORI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE SHKODËR, ANA E MALIT, BËRDICË, DAJÇ, GURI I ZI, RRETHINAT DHE VELIPOJË TË BASHKISË SHKODËR DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE BUSHAT TË BASHKISË VAU I DEJËS)”**

Në mbështetje të Kreut 3, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e Objektivave për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës), me qëllim reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, si më poshtë:
  - a. Përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe profesionale për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet;

- REPUBLIKA E
- b. Parandalimi i rreziqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet;
  - c. Reduktimi i rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet;
  - d. Reduktimi i pasojave negative gjatë një ngjarjeje përmbytjeje;
  - e. Reduktimi i pasojave negative pas një ngjarjeje përmbytjeje.

- 2. Objektivat, së bashku me objektivat specifike në funksion të tyre, janë pjesë e Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet, i cili përfshin masat konkrete që duhet të zbatohen për arritjen e objektivave.
- 3. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për monitorimin dhe vlerësimin periodik dhe përfundimtar të përmbushjes së objektivave, gjatë fazës së zbatimit të Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BEKIMOK BALBUKU

